



*Kuvendi i Komunës Klinë*

01Nr. 06-9263 /2026

Datë: 01.04 /2026

*Duke u mbështetur në shkronjën n) dhe r) të nenit 17, nenin 40. paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-040, Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048, Nenit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03.L-049, nenit 7 dhe 8 të Rregullores për Subvencione dhe Transfere /2015, nenin 40 pikën 3) të Statutit të Komunës, me kërkesën nr .prot. 01-401-6584/2026 të datës 04.03.2026 e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, si dhe me Rekomandimet e KPF-së të datës:18.03.2026, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur me datën: 27.03.2026, mori këtë:*

## V E N D I M

*Për*

*ndarjen e mjeteve buxhetore për mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë”*

1. Miratohet kërkesa e DKRS-së për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej **30,000.00** euro (Tridhjetë mijë) euro, për organizimin dhe mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë.”
2. Vendimi si në nenin 1 të këtij Vendimi miratohet me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me nr. prot. **01-401-6584/26 të datës 04.03.2026.**
3. Mjetet ndahen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në DKRS, Programi (850), Nën programi (85018) Kodi funksional (0820) ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi obligohen drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
4. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

*Me këtë vendim njoftohen:*

- *MAPL;*
- *Kryetari i Komunës;*
- *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;*
- *Zyra për Informim;*
- *Arkivi.*



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Enver Berisha**